REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

# RAPORTIMI JANAR-PRILL 2017

## FUSHA PRIORITARE 02: DREJTIM EKONOMIK

### 1- AKTIVITETE NË PROÇES:

Statistikat Financiare të Qeverisë sipas Manualit të Fondit Monetar Ndërkombëtar GFSM2014 janë në proces përpilimi dhe do të publikohen brenda datës 30 Qershor 2017 në format paraprak dhe brenda datës 30 Shtator 2017 në format përfundimtar, në respektim të afateve të parashikuara.

Pasqyrat Financiare të konsoliduara të qeverisë të cilat ofrojnë informacion mbi pozicionin dhe performancën e qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor janë në proçes përgatitje dhe do të përfundojnë brenda muajit Maj 2017, në respektim te afateve të parashikuara.

Statistikat e borxhit të cilat ofrojnë informacion mbi borxhin e brendshëm, borxhin e jashtëm, interesat e borxhit dhe borxhin e garantuar të qeverisjes së përgjithshme janë në proçes përpunimi për të dhënat e tre-mujorit të parë dhe do të publikohen brenda datës 30 të muajit prill.

### 2- AKTIVITETE TË PAREALIZUARA

Nuk ka

## FUSHA PRIORITARE 04: PERFORMANCE EKONOMIKE DHE SOCIALE

### 3- AKTIVITETE TË REALIZUARA:

**1.1 - Publikimi sipas kalendarit të parashikuar "Vlera e shtuar bruto, Tremujori III; Tremujori IV – 2016"**

Rezultatet tremujore, u janë paraqitur përdoruesve nëpërmjet zhvillimit të dy Konferencave të Shtypit, ditën e publikimit, duke respektuar principet e Kodit të Praktikës Evropiane, për një informim të njëhershëm si për institucionet qendrore, median dhe publikun e gjërë. Materialet shoqëruese janë të pajisura me njoftimet e

shtypit dhe shoqëruar me shënimet metodologjike, ku jepen sqarimet e nevojshme për metodologjinë e aplikuar, politikat e revizionimit, burimet e përdorura etj.

## 1.2 Transmetimi i të dhënave në EUROSTAT

Dërgimi i tabelave të kërkuara në kuadër të programit të transmetimit të ESA 2010 me SDMX është kryer në kohë. Është realizuar transmetimi i vazhdueshëm i tabelave të mëposhtme:

1- Table 0101 - Gross value added at basic prices and gross domestic product at market prices –tremujore
2- Table 0102 - GDP identity from the expenditure side – tremujore
3- Table 0120 - Exports of goods (fob) and services by Member States of the EU / third countries –tremujore
4- Table 0121 - Imports of goods (fob) and services by Member States of the EU/third countries –tremujore
5- Table 0200 - Main aggregates of general government –tremujore

Janë transmetuar për herë të parë tabelat e mëposhtme:

1 - Table 0900 - Detailed tax and social contribution receipts by type of tax or social contribution and receiving sub-sector including the list of taxes and social contributions according to national classification.

2 - Table 1001 - Tables by region (NUTS II)

3 - Table 1200 - Tables by industry, A6 and by region (NUTS III)

## 1.3 Aktivitete në kuadër të hartimit të Memorandumeve

- Përgatitje e urdhërit për ngritjen e grupeve të përhershëm të punës për funksionimin e MoU me BSH dhe MF.
- Pjesëmarrje në takime dhe përgatitje materialesh për hartimet e draft-Memorandumeve me institucionet e DPP, ISHP, SHKP, AKEP, etj.
- Hartimi i draft MoU midis INSTAT dhe AMF

### 1.4 Aktivitete të tjera të realizuara

- Monitorim dhe asistencë teknike për procesin e hedhjes së bilanceve
- Punime për standartizimin e kërkesave ndaj drejtorive të tjera në INSTAT
- Redaktimi i ESA 2010 dhe përkthim i fjalorit të termave statistikorë
- Manuali i procedurave të proceseve në llogaritë kombëtare vjetore
- Plotësim kërkesash për përdorues të ndryshëm
- Përditësim i GSBPM
-

## 4- AKTIVITETE NË PROÇES:

### 2.1 Vlerësimet e treguesve Tremujorë:

- Mbledhja e informacionit në mënyrë periodike për çdo ndërmarrje nga të gjitha burimet statistikore dhe administrative (ATN, TVSH, Ministria e Financave, Banka e Shqipëris, Sigurime Shoqërore etj), duke kryer ndërtimin e një database integruese të të gjitha burimeve.
- Integrimi i gjithë të dhënave të mbledhura; Rishikimi, vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë së të dhënave dhe ballafaqimi i burimeve
- Analiza dhe kontrolli në mënyrë individuale e subjekteve për llogaritjen e indikatorit të shifrës së afarizmit;
- Imputimet e pjesshme dhe të plota dhe ndërtimi i serive kohore të indikatorëve tremujor me çmimet korrente dhe çmimet mesatare të vitit të kaluar.
- Kryerja e operacioneve mjaft teknike si: Kalibrimi (benchmark-imi) i serive; Procesi chain-linking, me vit referencë, (2010=100); Përdorimi programit JDEMETRA+ për procesin e përshtatjeve sezonale.
- Analiza e indekseve të cmimeve përkatëse për vlerësimet me cmime konstante.
- Publikimi i PBB-së tremujore dhe njoftimi për shtyp
- Plotësimi i tabelave të trasmetimit ESA 2010 për EUROSTAT
- Plotësimi i databazës PCAXIS
- Mbledhja e informacionit mbi kërkesat për këta tregues

## 2.2 Vlerësimet e treguesve Vjetorë:

Gjatë kësaj periudhe DLLK merret kryesisht me mbledhje informacioni nga Drejtori të tjera në INSTAT apo nga institucione të tjera, sic mund të jetë Banka e Shqipërisë, Ministria e Finanacve, AMF etj.

Punime intensive për të kryer ***vlerësimet finale të vitit 2014 dhe gjysëm finale 2015 të PBB me metodën e prodhimit e shpenzimeve***, veçanërisht:

- Mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, nga të gjitha burimet statistikore dhe administrative, të nevojshëm për vlerësimet e PBB me metodat e prodhimit dhe të komponentëve përbërës të metodës së shpenzimeve, sipas koncepteve të llogarive kombëtare.
- Kryerja e analizave dhe kontrolleve në nivel mikro dhe makro të të ardhurave, shpenzimeve dhe punësimit për llogaritjen e treguesve të prodhimit, konsumit ndërmjetës, vlerës së shtuar dhe produktivitetit të ekonomisë së vrojtuar, për degën e Industrisë; Ndërtimit; Tregti, Hotele-Restorante; Transport-Magazinim, IT dhe Komunikacion; Shërbimeve të tjera.
- Vlerësime për ekonominë e pavrojtuar sipas kërkesave të metodës Tabulare të EUROSTAT.
- Mbledhja dhe analiza e gjithë burimeve të informacionit për vlerësimin e ***Konsumit final*** (Familjeve, Qeverisë dhe organizatave jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve të familjeve), ***GFCF*** me çmime korrente dhe konstante, dhe ***Eksporteve neto*** (në përputhje me konceptet dhe klasifikimet e përcaktuara në Manualin e 6 të bilancit të pagesave, BPM6).

## 2.2 Vlerësimet e tabelave burime – përdorime

- Marrja e të dhënave për përpilimin e tabelave të burim-përdorimeve për vitin 2014 me çmime korrente dhe të vitit të mëparshëm.
- Analiza dhe kontrolli i burimeve të të dhënave të disponueshme deri në këtë pikë të procesit.
- Përpilimi i komponentëve të tabelave të burimeve dhe përdorimeve për vitin 2014. Puna është fokusuar në ndërtimin e komponentëve të tabelave duke u bazuar në nivelin më të detajuar të mundshëm të burimeve të të dhënave, për periudhën e raportuar janë përpiluar matrica e outputit, importe, taksat në nivel produkti, konsumi ndërmjetës, eksporti, ndryshimi gjendja.
- Analiza dhe kontrolle në nivel mikro dhe makro të komponentëve të TBP-ve. Nisur nga vlerësimet e kryera në nivel ndërmarrje është mundësuar një unifikim i informacionit për çdo aktivitet ekonomik.

### 2.3 Vlerësimet e dy llogarive të para sipas sektorëve institucional

Ky objektiv ka të bëjë me përpilimin e dy llogarive të para (Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave) për sektorët institucional (Sektori i Institucioneve Jo-financiare (S11), Sektori Financiar (S12), Familjeve (S14), Sektori i Qeverisë dhe Organizatave Jo-fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (S15)), realizuar kjo nëpërmjet integrimit të informacionit statistikor ekzistues mbi sistemin ekonomik e social të vendit dhe aplikimit të kombinuar të metodave balancuese. Puna lidhet kryesisht me mbledhjen, përpunimin dhe analizën e informacionit për çdo sektor institucional të veçuar të ekonomisë për vitin 2013, konkretisht:

- Për ***Sektorin Jo-financiar*** është kryer integrimi i të dhënave të ASN, pasqyrave financiare të ndërmarrjeve, të dhënat e sigurimeve shoqërore, TVSH. Për kryerjen e korrektimeve janë përdorur të dhënat e ekonomisë së pavrojtuar, fitimet e pashpërndara, FISIM.

- Është bërë përpilimi i dy llogarive të para, Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave për vitin 2013.
- Për ***Sektorin e Familjeve*** janë përdorur vetëm të dhënat për familjet si njësi ekonomike. Vlerësimi është bërë për Llogarinë e Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave për vitin 2013.
- Për ***Sektorin e Institucioneve jo-fitimprurëse*** është bërë përpilimi i dy llogarive të para, Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave për të njëjtën periudhë.

## 2.4 Vlerësimet në kuadër të realizimit të objektivave të projekteve IPA 2014: PP1, PP2, PP3 dhe PP20

Llogaritë Kombëtare asistohen nga projekti IPA 2014 MB me 4 projekt pilote, si më poshtë:

***PP1: Methodologjia e Llogarive Kombëtare,*** i cili si objektiva të tij ka: Zhvillimin e tabelave Burim-Përdorime, realizimin e një assessment të vlerësimeve aktuale të llogarive sipas sektorëve institucional, Tabelat e procesimit, zhvillime metodologjike në kuadër të ESA 2010 (Programet kompjuterike për llogari të vet; kalimi nga GDP në GNI; Konsumi i kapitalit fiks dhe stoku i kapitalit; zyrat e këmbimit valutor; Përditësimi i materialit metodologjik “Description of sources and methods”).

***PP2: Transmetimi i të dhënave ESA 2010 dhe Llogaritë kombëtare tre-mujore,*** i cili ka këto objektiva kryesore: Përmirësimi në mënyrë të konsiderueshmë i transmetimit të të dhënave të Llogarive Kombëtare sipas Programit të Transmetimit të ESA 2010, Asistencë në fushën e transmetimit të të dhënave nëpërmjet platformës SDMX, Përmirësimi i vlerësimeve të Llogarive Kombëtare tre-mujore.

***PP3: Statistikat Financiare të Qeverisë -*** është një projekt i përqëndruar në përmirësimin e statistikave të qeverisë si dhe në rritjen e treguesve të dërguar në EUROSTAT.

***PP20: Procedura e Imbalancës makroekonomike (MIP-eng) -*** është një projekt në

bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë ku dy institucionet kanë si objektiv vlerësimin e serive të të dhënave të disponueshme dhe dokumentimit e metodologjisë së përpilimit sipas kërkesave të projektit.

Gjaë periudhës Janar-Prill, Drejtoria ka punuar maksimalisht për realizimin e objektivave të këtyre projekt piloteve, duke u përqëndruar në sigurimin e informacionit të nevojshëm, kryerjen e nje sërë studimeve dhe punimeve eksperimentale për aplikimin e metodikave të rekomanduara nga ekspertët, në përpilimin dhe përgatitjen e rezultateve për t'i prazantuar në Workshop-et përmbyllëse që do të zhvillohen në muajin Maj 2017.

**Moduli 04.01.14** LLOGARITË FINANCIARE - METODOLOGJIA

Deri tani, janë mbledhur, përpunuar dhe hartuar të dhënat për korporatat e tjera depozituese, bankën qendrore, fondet e investimeve dhe ndërmjetësit financiarë. Është në proces puna për mbledhjen e informacionit nga ndihmësit financiarë dhe kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve. Është hartuar metodologjia e statistikave të llogarive financiare draft e cila brenda vitit 2017 do të publikohet për përdoruesit

**Moduli 04.01.15** LLOGARITË FINANCIARE – PRODHIMI I TË DHËNAVE

Gjatë vitit 2017 do të publikohen për herë të parë llogaritë financiare për sektorin e korporatave financiare.

.

**Moduli 04.01.16** TREGUESIT MONETARË DHE FINACIARË

Në treguesit monetarë dhe financiarë është parashikuar që në fund të vitit 2017 të publikohen për herë të parë *bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e institucioneve të tjera financiare*. Lidhur me këtë aktivitet është hartuar bilanci sektorial dhe paraqitja monetare për nën sektorin e ndërmjetësve financiarë. Ndërkohë, sapo ka filluar puna për mbledhjen e informacionit të ndihmësve financiare, fondeve të investimit dhe fondeve të pensioneve, dhe me ndihmën e asistencës teknike të FMN-së të parashikuar gjatë

tremujorit të dytë të vitit do të hartohen statistikat e ndihmësve financiarë dhe fondeve të investimit dhe finalizimin e hartimit të statistikave të institucioneve të tjera financiare. Gjithashtu, në këtë modul është parashikuar edhe zhvillimi i metodologjisë dhe hartimi i statistikave të normave të interesit, sipas kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Rezultati i këtij objektivi do të jetë hartimi dhe publikimi në fund të vitit 2017 i *normave të interesit për depozitat dhe huatë e reja/ dhe gjendje*. Për realizimin e këtij aktiviteti, janë krijuar format e reja të raportimit dhe manuali përkatës për raportimin e të dhënave të nevojshme nga bankat para-depozituese. Draft rregullorja është shpërndarë dhe është në diskutim më bankat

## FUSHA PRIORITARE 05: QENDRUESHMERIA E MJEDISIT

Moduli 05.1.21 LLOGARITË MONETARE MJEDISORE

**Aktivitete të realizuara**

Nuk ka aktivitete të planifikuara dhe të realizuara ende ne 4 mujorin e parë

**Aktivitete në proces**

Ndërtimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme si burim informacioni si dhe diskutime ndërmjet sektorit të llogarive ekonomike në bujqësi dhe mjedis dhe drejtorisë së llogarive kombëtare mbi përmirësimin e cilësisë së treguesve si dhe shtimin e fushave të të dhënave të raportuara.

MODULI 05.01.22 LLOGARITË FIZIKE MJEDISORE

**Aktivitete të realizuara**

Nuk ka aktivitete të planifikuara dhe të realizuara ende ne 4 mujorin e parë

**Aktivitete në proces**

Finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare e Mjedisit si dhe përfshirja e treguesve të nevojshëm në memorandumet e bashkëpunimit me Ministritë dhe Agjencitë e tjera të përfshira si AKBN, Gjeoum, etj.

**Problematika**

Vonesa në marrjen e informacionit dhe përgjigjeve përkatëse nga AKM lidhur me memorandumin.

**FUSHA PRIORITARE 06: STATISTIKAT E NDERRMARJEVE EKONOMIKE**

*Përshkrimi:* Drejtoria e Statistikave Ekonomike përcakton, harton, përpunon dhe publikon të gjithë treguesit statistikorë të ndërmarrjeve, shkëmbimit të mallrave dhe çmimeve të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe në planin vjetor të punës të Institutit të Statistikave. Drejtoria përbëhet nga 4 sektorë: Sektori i Rregjistrit statistikor; Sektori i Statistikave Strukturore; Sektori i Statistikave Afatshkurtra; Sektori i Tregtisë, Turizmit dhe Transportit.

**Aktivitete të realizuara**

- Rregjistri statistikor i ndërmarrjeve u përfundua për nevoja të përgatitjes së kampioneve në 17 Shkurt 2017, sipas vendimit të marrë, ndërkohë që regjistri i Ndërmarrjeve (I ngrirë) u përgatit në 31 Mars 2017, sipas afatit;
- Për përditësimin e RSN u përdorën si burimet administrative edhe vrojtimet statistikore. U përgatit MoU me QKB, me qëllim rritjen e cilësisë së burimeve administrativ.
- Statistikat mbi Cmimet e Prodhimit, Importit, Ndërtimit, për tremujorin e katër 2016 u llogaritën dhe u publikuan sipas afatit të vendosur ne kalendarin e botimeve.
- Statistikat Afatshkurtra për tremujorin e katër 2016 u llogaritën dhe u publikuan në kohë, sipas Kalendarit të botimeve.
- Gjatë kësaj periudhe është organizuar vrojtimi për tremujorin e parë mbi Cmimet dhe Treguesit tremujorë të ndërmarrjeve sipas kalendarit të aktiviteteve.
- Organizimi i Anketës Pilot për Çmimet e Shërbimeve, u organizua për herë të parë. Të dhënat janë në process përpunimi.
- Llogaritja dhe publikimi i Lejeve të Ndërtimit_Tr.4.2016, u krye sipas kalendarit. Për të angazhuar të njësitë bashkiake, ju dërguan shkresa zyrtare pranë tyre të shoqëruar me formatet e pasqyrave statistikore të përshtatura sipa kërkesave të Eurostatit.
- Janë kryer disa përkthime nga SASH si përkthimi i klasifikimit të detajuar të Ndërtimit, Politikat e rishikimit të SASH.

- Kampionimi i ndërmarrjeve dhe produkteve për indekset e Çmimeve _Tr.1.2017 janë kryer nga SSASH duke ndjekur kriteret metodologjike.
- Publikimi i Rezultateve Finale të ASN 2015 u krye në kohën dhe afatin e duhur. Botimi I këtij viti përmbante edhe analizë pesëvjecare në të,
- Për herë të parë u përgatit raporti I cilësisë, I cili u publikua në të njëjtën ditë me botimin. Gjithashtu botimi u shoqërua me Njoftimin për shtyp. U përgatiten dhe tabelat në PC-axis përb. Gjithashtu janë kryer: Përgatitja e materialeve për arshivim dhe data ëarehouse; Përgatitja e bazave dhe tabelave specifike për sektorë të tjera brenda drejtorisë;Përgatitja e bazave dhe tabelave specifike për drejtori të tjera brenda INSTAT;Përgatitja e bazave dhe tabelave specifike për përdorues të jashtëm
- Publikimi i Bilancit të Energjisë elektrike viti 2016, u krye sipas kalendarit të botimeve, duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm, nga shkresat zyrtare deri në publikimin e plotë. Për herë të parë u përgatit raporti I cilësisë për këtë aktivitet dhe u publikua në të njëjtën ditë me botimin.
- Kryerja e vrojtimit të TIK 2016 edhe këtë vit u organizua me Tablet në të gjithë territorin e vendit, duke ndjekur hapat e vrojtimi sipas kalendarit të aktiviteteve.
- Ky sektor ka përkthyer politikat e rishikimit për statistikat e Energjisë.
- Këtë vit krahas botimit mujor të Tregtisë së jashtme, I cili është afruar 10 ditë nga data e planifikuar në kalendarin e vitit të kaluar, duke shkuar më pranë përdoruesve, setit të botimeve mujore I janë shtuar edhe disa botime të tjera: Aksidentet rrugore mujore, Levizjet e shtetsve dhe Transporti sipas llojit. Botimet mujore janë publikuar në kohë sipas kalendarit të botimeve.
- Eshtë përgatitur botimi 5 vjecar, Ecuria e Tregtisë së Jashtme, në kohën e duhur shoqëruar për herë të parë me Njoftim për shtyp.
- Ka filluar vrojtimi pilot i Turizmit në 48 ndërmarrje të selektuar sipas metodologjisë për të testuar pyetsorin dhe problematika të tjera të cilat duhet të merren parasysh gjatë vrojtimit të plotë.
- Është punuar për inventarizimin e treguesve të Trasnportit sipas llojeve.
- Nga sektori I TTT është përkthyer Nomenklatura e Transporteve.

*II. Aktivitete të parashikuara, por të pamundura për tu realizuar*

- Ngritja e regjistrit te Grupeve të Ndërmarrjeve

*III. Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*

- Organizimi i SBR User Group dhe përgatitja e raportimit mbi situatën e RSN

- Manuali i procedurave
- Llogaritja e deflatorëve për DLLK
- Përgatija e GSBPM në nivel aktiviteti
- Përgatija e Memorandumeve te mirëkuptimit;
- Planifikimi i buxhetit per periudhen 2017-2020
- Pjesmarrje mujore te tre përfaqësuesve të sektorit në takimet e GNP kapitujt 20,22 dhe 25
- Pjesmarrje në takime të tjera pune brenda dhe jashtë insitucionit
- Detyra të tjera të ngarkuara nga drejtori i drejtorisë dhe bashkëpunimi me sektorë të tjerë brenda INSTAT ose jashtë institucionit

IV. *Objektiva dhe aktivitete në process*

- Finalizimi i regjistrit të njësive Lokale;
- Përgatitja e tabelave dhe publikimit mbi regjistrin statistikor të Ndërmarrjeve 2016
- Plotësimi dhe përditësimi i GSBPM nga të gjithë sektorët.
- Llogaritja e statistikave tremujore sipas BR, ka përfunduar kontrolli dhe janë dërguar skedarët e të dhënave për llogaritje tek sektori I metodologjisë.
- Përgatitja për terrenin e vrojtimit të ASN 2017 sipas kalendarit të aktiviteteve, duke ndjekur hapat: Identifikimi i nevojave dhe dizenjimi i pyetësorëve të ASN 2017; Planifikimi i periudhës, kritereve, detyrave dhe numrit të stafit mbështetës anketues, kontrollor dhe operator për kryerjen e vrojtimit të ASN 2017; Identifikimi i nevojave dhe përgatitja e materialeve të nevojshme nga vrojtimet e kryera në vitet e kaluara.

V. *Aktivitete të pa-parashikuara por të realizuara*

- Përgatitja e njoftimit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2015;
- Përgatitja e njoftimit për Bilancin e Gjashtëmujorit të dytë të energjisë elektrike 2016;

**Sektori i Cmimeve**

1. *Përshkrimi: Sektori i Cmimeve….*
   - Periudha e Raportimit: Janar – Mars 2017
2. *Objektiva dhe rezultate*
   - Objektivi 1 –Llogaritja e ICK, mujore
   - Aktivitete te realizuara:
     - ✓ ICK është llogaritur çdo muaj dhe publikuar sipas Kalendarit të botimeve.

- ✓ Kontrolli i formularëve të çmimeve të konsumit të muajit Dhjetor 2016, Janar, Shkurt 2017.
- ✓ Pastrimi i të dhënave dhe llogaritja e IÇK-së së muajit Dhjetor 2016, Janar, Shkurt 2017.
- ✓ Përgatitja e formatit të publikimit dhe të dhënat për faqen e Ëeb Dhjetor 2016, Janar, Shkurt 2017.
- ✓ Llogaritja e koefiçientit të rivlerësimit.
- ✓ Llogaritja dhe publikimi i çmimeve mesatare për disa artikuj kryesor të konsumit.
- ✓ Llogaritja e deflatorëve
- ✓ Përgatitja e të dhënave të përshtatshme sipas kërkesave të përdoruesve të ndryshëm, brenda dhe jashtë INSTAT.

- Objektivi –Llogaritja e IHCK , mujore
- Aktivitete të realizuara:
  - ✓ Në muajin Shkurt u publikua për herë të parë
  - ✓ Përgatitja e formatit të publikimit për Dhjetor 2016, Janar, Shkurt 2017.
  - ✓ Përgatitja e formatit të transmetimit të HICP-së dhe dërgimi i tij me eDamis.
- Objektivi –Llogaritja e IKN, tremujore
- Aktivitete të realizuara:
  - ✓ Përgatitja e skedarit të llogaritjes për tremujorin e katërt 2016.
  - ✓ Grumbullimi, kontrolli dhe hedhja e të dhënave.
  - ✓ Llogaritja dhe publikimi i IKN tremujori i katërt 2016.
  - ✓ Përgatitja e shkrimorit, tabelave ëeb dhe tabelave për databasën.
  - ✓ Llogaritja e çmimeve mestare të materialeve kryesore të ndërtimit.
  - ✓ Përgatitja e sampe-it të ndërmarrjeve IKN-së IKN- Punime Inxhinierike për tremujorin e parë 2017.
  - ✓ Përgatitja e të dhënave të përshtatshme sipas kërkesave të përdoruesve të ndryshëm, brenda dhe jashtë INSTAT.
- Objektivi- Matja e barazisë së fuqisë blerëse
- Aktivitete të realizuara:
  - ✓ Realizimi i vrojtimit të qerave në bashkepunim me expertin nga OECD.
  - ✓ Mbledhja e të dhënave për vrojtimin "Hotelet" për sezonin dimëror. Llogaritja e peshave për vrojtimin "Hotelet" për sezonin dimëror dhe dërgimi i tyre me eDamis.
  - ✓ Kryerja e fazës së parë të pastrimit të të dhënave për vrojtimin E16-2 "Transport, Restorante dhe Hotele".
  - ✓ Kryerja e paravrojtimit për E17-1 "Shërbimet"dhe hedhja e informacionit të mbledhur në ILMT. Përgatitja e materialeve dhe pyetësoreve dhe fillimi i mbledhjes së të dhënave.
  - ✓ Kryerja e paravrojtimit për "Makineri dhe paisje 2017". Përgatitja e materialeve dhe pyetësoreve dhe fillimi i mbledhjes së të dhënave.

- ✓ Vazhdimi i fazës së dytë të pastrimit të dhënave për vrojtimin “Ndërtimi 2016”
- ✓ Kryerja e paraparavrojtimit per E18-1 “Ushqime, pije dhe duhan”
- ✓ Transmetimin e IÇK me eDamis.

3. *Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*
   - Ska
4. *Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*
   - Manuali i procedurave
   - Kalimi I deflatorëve tek SSASH
5. *Objektiva dhe aktivitete në process*
   - Aktiviteti 1:
   - Vrojtimi i E17-1 “Shërbimet”
   - Aktiviteti 2:
   - Vrojtimit për “Makineri dhe paisje 2017”.

**FUSHA PRIORITARE 07: NJERZIT E EVROPËS**

Drejtoria e Statistikave Sociale përcakton, harton, përpunon dhe publikon të gjithë treguesit statistikore socialë, të miratuar në Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ) dhe në planin vjetor të punës së INSTAT. Në procesin e punës për realizimin e objektivave të vendosur në PSZ kjo drejtori komunikon, bashkëpunon dhe bashkëvepron me të gjithë drejtoritë e tjera në INSTAT dhe sektorët e tyre përbërës.

**Sektori i Statistikave të Popullsisë** në mbështetje të Programit Kombëtar Statistikor, ka si objektiv të organizojë punën për mbledhjen, kontrollin, analizën dhe prodhimin e treguesve statistikore të demografisë, arsimit dhe shëndetësisë në Shqipëri.

**Aktivitete të realizuara**

1. *Objektiva dhe rezultate*
   - Llogaritja dhe publikimi i Popullsisë 1 Janar 2017;
     a. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për sigurimin e të dhënave të statistikave vitale (Lindje, Vdekje, Lëvizjet e Brendshme);
     b. Mbledhja e të dhënave mbi migracionin për vitin 2016 nëpërmjet AFP, gjetja e metodologjisë adekuate (duke patur parasysh metodologjinë që ndjek AFP) për llogaritjen e indikatorëve të migracionit;
     c. Përgatitja e tabelave dhe materialeve të tjera paraprake të popullsisë;

d. Përgatitja e Press Realease, metodologjisë së përdorur dhe analizimi i rezultateve;

- Pasurimi me tabela për vitin 2016 dhe përditësimi i WEB-it, lidhur me statistikat vitale si dhe indikatorët kryesorë demografik.
- Prodhimi i tabelave dhe pjesës shkrimore për publikimin e Buletinit T4 2016.
    a. Bashkëpunimi me DPGjC për sigurimin e të dhënave të statistikave vitale;
    b. Përpunimi i databasave, pastrimi, editimi dhe kontrolli i plotshmërisë së variablave;
    c. Llogaritja e treguesve të lindjeve, vdekjeve, martesave dhe shtesës natyrore sipas qarqeve dhe 4 tremujorëve të vitit.
- Marrja, kontrolli dhe përpunimi i të gjithë treguesve statistikorë për shëndetësinë.
    a. Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me institucionet e linjës për sigurimin e statistikave të shëndetësisë;
    b. Marrja, kontrolli dhe përpunimi i të dhënave nga evidencat statistikore të Ministrisë së Shëndetësisë;
    c. Pastrimi dhe klasifikimi i të dhënave administrative lidhur me shkaqet e vdekjes dhe kodin e sëmundjeve për vitet 2015-2016.
- Marrja, kontrolli dhe përpunimi i të dhënave të regjistrimeve të arsimit parauniversitar dhe universitar të vitit të fundit, si dhe llogaritja e indikatorëve përkatës.
    a. Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit për sigurimin e cilësisë dhe plotshmërisë së të dhënave të sistemit arsimor;
    b. Kontrolli i të dhënave të ardhura nga evidencat statistikore;
    c. Llogaritja e indikatorëve të regjistrimit parauniversitar sipas niveleve arsimore, gjinisë, qarqeve dhe staf, institucione etj;
    d. Përpunimi dhe llogaritja e GER, NER, GPI, pas rivizionimit të popullsisë që prej vitit 2011 e në vazhdim.
- Finalizimi i shkresave për lidhje me memorandumet me institucionet përkatëse bashkëpunuese.
    a. Hartimi MoU dhe përpilimi i anekseve me të dhëna;
    b. Dërgimi i draft memorandumit në institucione: MSH, ISHP, FSDKSH;
    c. Takime bilaterale ndërmjet institucioneve për finalizimin e procesit;
    d. Takime mbi treguesit statistikor me specialistët e fushës, koordinimi për çështjet që lidhen me anën juridike të memorandumit.

- Rishikimi i materialit final dhe përmbledhës të PSZ 2017-2021(edhe në versionin anglisht).

- Puna përgatitore për fillimin e anketës, konsultimi dhe konfirmimi i nevojave për anketën e arsimit të të rriturve, AES 2017;
    a. Hedhja e kampionit nga metodologjia;
    b. Përkthimi i pyetsorit si dhe i manualit;

2. *Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*
   *Nuk ka*
3. *Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*
   - ✓ Revizionimi i popullsisë;
   - ✓ Hartimi i raporteve të cilësisë;
   - ✓ Takime mbi Censusin e ardhshëm, përgatitje paraprake;
   - ✓ Takime mbi projektit pilot (PP20), IPA 2014 "Source (basic) data required for the calculation of the indicators for the Macroeconomic imbalances procedure (MIP);
   - ✓ Mbështetje për ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave të AES.

**Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave (SSTTP)**

**Aktivitete të realizuara**

1. *Objektiva dhe rezultate*
- Të sigurohet kryerja në terren e Anketës së Forcave të Punës 2017 në afat dhe cilësi nëpërmjet organizimit të punës së anketuesve, ndjekjes së ecurisë së terrenit si dhe kryerjes së kontrollove periodike.
    a. Realizimi i hedhjes në terren të anketës për tremujorin e parë 2017.
    b. Ndjekja e ecurisë së AFP_ T1 dhe T2_2017 dhe supervizimi i punës në terren.
    c. Përgatitja dhe kontrolli i skedarëve përfundimtarë të T1_2017.
- Të realizohet përpunimi dhe publikimi në afat i rezultateve të AFP.
    a. Kontrolli i kodifikimeve të profesioneve (sipas ISCO-08) dhe aktiviteteteve ekonomike (sipas NACE REV.2) T4_2016.
    b. Pastrimi i të dhënave dhe derivimi i variablave të reja.
    c. Përllogaritja e treguesve, analiza dhe publikimi i rezultateve të AFP_T4_2016.
    d. Përgatitja dhe publikimi i tabelave për Web.

- Përfundimi i proçeseve të llogaritjes së indikatorit mbi punësimin, papunësinë dhe ndihmën ekonomike (të dhëna administrative):
    a. Përfundimi i proçesit të kontrollit të të dhënave nga pasqyrat statistikore të programit statistikor, burim ZR dhe institucionet e tjera shtetërore.
    b. Përpunimi i të dhënave.
    c. Përgatitja e tabelave për Botimin "Buletini Statistikor" dhe për WEB.
- Përfundimi i proçeseve të llogaritjes së indikatorit mbi pagat:
    a. Përfundimi i proçesit të kontrollit të të dhënave nga listëpagesa me burim Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
    b. Derivimi i të dhënave.
    c. Përgatitja e tabelave për Botimin Tregu i Punës 2016.

- Realizimi i botimit vjetor "Tregu i Punës, 2016"
    a. Përgatitja e skedarit me të dhëna vjetore.
    b. Përllogaritja e treguesve dhe prodhimi i tabelave për botim.
    c. Përgatitja e materialit përkatës shkrimor dhe grafikëve.
- Të sigurojë kryerjen e Anketës së Kostos së Punës 2016:
    a. Hartimi dhe finalizimi i buxhetit të Anketës së Kostos së Punës 2016;
    b. Dizenjimi i pyetësorit si dhe i manualit;
    c. Finalizimi i pyetësorit dhe manualit;
    d. Organizimi i trajnimit të anketuesve;
    e. Ndjekja dhe mbështetja në ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave me kushtet logjike;

*2. Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*

*Nuk ka*

*3. Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*

- Përgatitja e kampionit dhe peshave për AFP tremujore 2017 dhe për Anketën e Kostos së Punës 2017.
- Përgatitja e hartave të AFP tremujore 2017.
- Azhornimi i programit të hedhjes së të dhënave të AFP tremujore 2017;
- Përgatitja e programit të hedhjes së të dhënave të Anketës së Kostos së Punës 2017.

- Supervizimi i punës në terren për mbledhjen e të dhënave të Anketës së Kostos së Punës 2017 dhe i procesit të kontrollit dhe hedhjes së të dhënave.
- Hartimi i raporteve të cilësisë;

4. *Objektiva dhe Aktivitete në proces*
   - Kryerja e Anketës Tremujore të Forcave të Punës 2017;
   - Kryeja e Anketës së Kostos së Punës 2017 (me vit reference 2016);
   - Kryerja e studimit pilot mbi zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare në AFP;
   - Përgatitja e tabelave bazuar në të dhënat e AFP për llogari të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare;
   - Harmonizimi i variablave me formatet e Eurostat për transmetimin e të dhënave, përgatitja e skedarëve longitudinalë dhe standardizimi i proceseve statistikore.

**Sektori i Analizave Socio-Demografike**

**Aktivitete të realizuara**

1. *Objektiva dhe rezultate*

- Ndërtimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm dhe të besueshëm për statistikat me burim administrativ:
  a. Hartimi i Memorandumeve të bashkëpunimit me Drejtorinë e Policisë, Drejtorinë e Burgjeve si dhe Ministrinë e Kulturës. Për këto memorandume është përgatitur lista e treguesve që INSTAT synon të publikojë bazuar në PSZ 2017-2021, si dhe frekuencat për të dhënat e kërkuara.
  b. Përgatitja e një raporti të cilësisë për statistikat e krimeve.
- Harmonizimi i statistikave me kërkesat e EU
  a. Fillimi i punës për implementimin e klasifikimit ndërkomëtar të krimeve për qëllime statistikore ICCS. Ky aktivitet ende kërkon kohë pasi nga Eurostat nuk kanë dalë ende rregulloret respektive. Megjithatë janë organizuar takime me aktorët pjesmarrës për t'i bërë me dije për këtë iniciativë të INSTAT si dhe fillimi i një hartëzimi nga Kodi Penal drejt ICCS.
  b. Plotësimi dhe dërgimi i *Pyetesorit (Crime & Criminal Justice Statistics - Eurostat)*, mbi aktivitetet kriminale të mundësimit të hyrjes, transportit dhe qëndrimit të paautorizuar.
- Skicimi i publikimit Femra dhe Meshkuj.

a. Hartimi i të gjithë shkresave rutinë për institucionet e treta duke u bazuar në treguesit e mëparshëm.
b. Hulumtumi i botimeve të tjera dhe për pasojë përfshirja e treguesve të rinj në këtë botim.
c. Përgatitja e tabelave në excel për sektorët e tjerë në INSTAT që furnizojnë më të dhëna për këtë publikim.

– Kryerja e analizave
  a. Fillimi i punës për llogaritjen e treguesit të pabarazisë gjinore në pagë me të dhëna administrative nga Drejtora e Përgjithshme e Tatimeve.
– Bashkëpunimi me institucone të tjera për ngritjen e kapaciteteve
  a. Projekti "Matja dhe vlerësimi i krimit të organizuar në vendet perëndimore të Ballkanit" në bashkëpunim me UNODC.
  b. Fillimi i punës për raportin "Aksesi i fëmijëve në Drejtësi", në bashkëpunim me UNICEF
  c. Mision nga IPA 2 ditor mbi "Trafikimin e Qënieve Njerëzore"
  d. Përgatitja e një workshopi në bashkëpunim me projektin SIDA për fillimin e një publikimi të ri të dedikuar për statistikat e krimeve. Përgatitja e një draft tabele përmbatje e cila do të ndjekë rrjedhën e Kodit Penal në paraqitjen e krimeve në botimin e ri.
  e. Puna me projektin pilot për statistikat e krimeve për implementimin e klasifikimit ndërkombëtar për krimet.
– Finalizimi i shkresave që kanë lidhje me të dhënat e publikuara nga sektori.
– Rishikimi i materialit final dhe përmbledhës të PSZ 2017-2021 (edhe në versionin anglisht). Plotësimi i programit në Akses për treguesit e sektorit.

2. *Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*

*Nuk ka*

3. *Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*

– Hartimi i raporteve të cilësisë për statistikat e krimeve.
- Asistencë për llogaritjen e popullsisë 1 Janar 2017 dhe rishikimin e vlerësimeve të popullsisë për periudhën 2011-2016.
- Llogaritje e popullsisë sipas ndarjes urban/rural 2016-2017.
- Monitorimi i procesit të asgjesimit të materialeve të Censusit 2011.

4. *Objektiva dhe Aktivitete në proces*

- Finalizimi i publikimit “Femra dhe Meshkuj”.
- Finalizmi i llogaritjes së treguesit të hendekut gjinor në paga.
- Finalizimi i raportit për projekt pilotin e statistikave të krimeve.
- Bazuar në Memorandumet që presim të nënshkruhen brenda muajit Prill, fillimi i punës me përgatitjen për publikimin më të afërt “Shqipëria në Shifra”.

**Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve**

**Aktivitete të realizuara**

1. *Objektiva dhe rezultate*

- Përfundimi i proceseve të Anketës së Buxhetit të Familjes 2016.dhe vazhdimi i proceseve të ABF 2017:
    a. Përfundimi i procesit të kontrollit dhe hedhjes së të dhënave për ABF 2016 dhe 2017 (në proces).
    b. Editimi dhe imputimi i të dhënave të ABF 2016;
    c.
    d. Përgatitja e tabelave dhe materialeve të tjera paraprake të ABF 2016;
- Të sigurohet kryerja në terren e Anketës së Buxhetit të Familjes 2017 (ABF) në afat dhe cilësi nëpërmjet organizimit të punës së anketuesve, ndjekjes së ecurisë së terrenit si dhe kryerjen e kontrollove periodike.
-
- Të përllogaritet shkalla e përgjigjes së Anketës të Buxhetit të Familjes 2016.
    a. Të realizohet raportimi periodik lidhur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të sektorit gjatë vitit 2016;
    b. Të realizohet dokumentimi i plotë në format elektronik dhe letër i të gjithë materialeve të anketës ABF 2016.
- Rishikimidhe hartimi i pyetësorit për Pilot CAPI SILC 2017.
- Vazhdimi i kryerjes së procesit të pastrimit dhe përditësimi i programeve në SAS të të valës së parë të anketës SILC 2016.
- Finalizimi i shkresave për lidhjen e memorandumeve me institucionet përkatëse bashkëpunuese në kuader të SILC 2017.
- Rishikimi i materialit final dhe përmbledhës të PSZ 2017-2021 (edhe në versionin anglisht).
- Të sigurojë kryerjen në terren të anketës së Turizmit në Familje 2017:

a. Hartimi dhe finalizimi i buxhetit të anketës së Turizmit në Familje 2017;
b. Dizenjimi i pyetsorit si dhe i manualit;
c. Testimi i pilotit të pyetsorit;
d. Finalizimi i pyetsorit dhe manualit;
e. Ndjekja dhe mbështetja në ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave me kushtet logjike;
f. Planifikimi i volumit dhe normës mujore për çdo anketues shoqëruar me ditët e punës.

- Të sigurohet aplikimi i nomenklaturës së produkteve dhe kontrolli i kodeve të produkteve në llogaritjen e treguesve kryesorë të shpenzimeve të konsumit bazuar në aktet ligjore të vendit dhe rekomandimet e EUROSTAT - COICOP 2012.

2. *Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*
   *Nuk ka*
3. *Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*
   - Hartimi i raporteve të cilësisë;
   - Pastrimi i të dhënave të Anketës së Buxhetit të Familjes 2016;
   - Azhornimi i programit të hedhjes së të dhënave të ABF 2016;
   - Mbështetje për ndërtimin e programit të hedhjes së të dhënave të anketës së Turizmit në Familje 2017;

4. *Objektiva dhe Aktivitete në proces*
   - Vlerësimi i të dhënave paraprake të ABF 2016;
   - Kryerja e draft raporti i cilësisë për ABF 2016;
   - Ndjekja e ecurisë dhe mbarëvajtjes së ABF 2017;
   - Finalizimi i të gjithe materialeve për fillmin e anketës (pyetsorë/manualë,etj)
   - Përfundimi i mbledhjes së të dhënave për tremujorin e parë të anketës së turizmit në familje 2017;

**Sektori i Nivelit të Jetesës (periudha e raportimit 1-30 Prill 2017)**

**Aktivitete të realizuara**

1. *Objektiva dhe rezultate*
   - Rishikimidhe hartimi i pyetësorit për Pilot CAPI SILC 2017.

- Vazhdimi i kryerjes së procesit të pastrimit dhe përditësimi i programeve në SAS të të valës së parë të anketës SILC 2016.
- Finalizimi i shkresave për lidhjen e memorandumeve me institucionet përkatëse bashkëpunuese në kuader të SILC 2017.

2. *Aktivitete të parashikuara por të pamundura për tu realizuar*
   *Nuk ka*
3. *Aktivitete në bashkëpunim me drejtori të tjera*

- Hartimi i raporteve të cilësisë;
- Pastrimi i të dhënave të Anketës SILC 2016;
- Azhornimi i programit të hedhjes së të dhënave të SILC 2017;

4. *Objektiva dhe Aktivitete në process*

- Vlerësimi i të dhënave paraprake të SILC 2016;
- Përgatitja e sistemit CAPI dhë përditësimi i pyetsorëve dhe manualeve të SILC 2017;

FUSHA PRIORITARE 08: STATISTIKAT SEKTORIALE, BUJQËSORE DHE MJEDISORE E GJEOHAPESINORE

*Nënmoduli: 08.1.42.04 Statistikat mbi cilësinë e ajrit, zhurmat, ujit, menaxhimit të mbetjeve.*

**Aktivitete të realizuara**

- Përgatitja dhe dërgimi i kërkesave të informacionit të nevojshme lidhur me prodhimin e treguesve përkatës institucioneve të ndryshme si AKM, Ministria e Mjedisit, AKBN Gjeoum, etj.
- Përgatitja lidhur me materialet metodologjike përkatëse si dhe pyetësori mbi vrojtimin vjetor të mbetjeve të ngurta urbane. Është përditësuar lista me ekonomitë të cilat ushtrojnë aktivitet në fushën e mbuluar nga ky vrojtim nëpërmjet regjistrit të ndërmarrjeve si dhe me informacionin e mbledhur nga çdo bashki.

**Aktivitete në proces**

Vijimi i implementimit të vrojtimit vjetor mbi mbetjet e ngurta urbane në terren si dhe përpunimi i të dhënave.

**MODULI 08.02.34 STATISTIKAT E PYLLTARISË DHE BIODIVERSITETIT**

**Aktivitete të realizuara**

Përgatitja dhe dërgimi i kërkesave të informacionit të nevojshme lidhur me prodhimin e treguesve përkatës institucioneve të ndryshme si AKM, Ministria e Mjedisit.

**Problematika**

Në kuadër të ndryshimit territorial si dhe kompetencave të disa institucioneve të ndryshme menaxhimi i zonave pyjore i ka kaluar 61 bashkive të reja, dhe nuk është e qartë kush duhet të realizoj dërgimin e të dhënave pranë INSTAT
Për këtë qëllim do të realizohen disa takime me Ministrinë e Mjedisit dhe AKM lidhur me mbledhjen e informacionit sa më të centralizuar duke shmangur kështu mbivendosjet ose problematikat nga transferimi i kompetencave si dhe nga paqartësia aktuale.

MODULI 08.02.32 STATISTIKAT E MBETJEVE DHE SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME

**Aktivitete të realizuara**

Përgjatë vrojtimit vjetor të mbetjeve të ngurta urbane do të mblidhen dhe të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme përfshirë ato spitalore të cilat do të raportohen përkatësisht.

**Aktivitete në proces**

- Mbledhja e të dhënave nëpërmjet vrojtimit statistikor por dhe të dhënave administrative lidhur me mbetjet e rrezikshme si dhe mbetjeve spitalore.
- Sa i përket mbetjeve industriale përgjatë 4 mujorit të tretë të vitit është planifikuar realizimi i një vrojtimi pilot mbi mbetjet industriale.
- Ndërkohë po vijon puna lidhur me përgatitjen e materialeve metodologjikë me mbështetjen e SIDA lidhur me vrojtimin e mbetjeve industriale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

MODULI 08.04.11 STATISTIKAT E BUJQËSISË DHE BLEGTORISË

## Aktivitete të realizuara

- Është realizuar planifikimi dhe implementimi i vrojtimit kalibrues për censusin e bujqesisë. Aktiviteti ka filluar në mesin e dhjetorit 2016 dhe ka vijuar deri në mes të janarit 2017.
- Është realizuar mbështetja metodologjike ndaj Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
- Janë implementuar vrojtimet mujore lidhur me çmimet e output-eve në bujqësi, mishit, qumështit dhe vezëve.
- Është implementuar vrojtimi vjetor i qumështit dhe nënprodukteve të tij për vitin 2017 (me të dhënat referuese për vitin 2016)
- Implementimi në muajin mars i vrojtimit tre mujor lidhur me çmimet e input-eve bujqesore
- Dërgimi i kërkesës për të dhënat administrative mbi sektorin bujqësor drejtuar Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
- Llogaritja e treguesve të nevojshëm si dhe dërgimi i tyre pranë drejtorisë së llogarive kombëtare për llogaritjen e PBB tre mujore.

## Aktivitete në proces

- Po vijohet puna për pastrimin dhe përpunimin e treguesve kalibrues për censusin e bujqesisë.
- Po vijohet puna lidhur me implementimin e vrojtimeve mujore për çmimet e output-eve në bujqësi, mishit, qumështit dhe vezëve
- Po vijon puna lidhur me pastrimin dhe përpunimin e të dhënave lidhur me vrojtimin vjetor të qumështit dhe nënprodukteve të tij.

## Problematika

Mbledhja e të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për vitin 2016 lidhur me sektorin bujqësor mbetet problematike.
Pavarësisht dërgimit të kërkesës për informacion akoma nuk kemi një përgjigje për të dhënat aministrative lidhur me vitin 2016 mbi sektorin bujqësor.

MODULI 08.04.12 STATISTIKAT E PESHKIMIT

**Aktivitete të realizuara**

- Dërgimi i kërkesës përkatëse Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave lidhur me treguesit tre mujor për sektorin e peshkimit
- Llogaritja e treguesve të nevojshëm si dhe dërgimi i tyre pranë drejtorisë së llogarive kombëtare lidhur me sektorin e peshkimit për llogaritjen e PBB tre mujore

**Aktivitete në proces**

Dërgimi i kërkesës së radhës për marrjen e të dhënave për tre mujorin e radhës lidhur me të dhënat e sektori të peshkimit

***MODULI 08.04.41 STATISTIKAT E PËRDORIMIT DHE MBULIMIT TË TOKËS***

**Aktivitete të realizuara**

- Është realizuar planifikimi dhe implementimi i vrojtimit kalibrues për censusin e bujqesisë. Aktiviteti ka filluar në mesin e dhjetorit 2016 dhe ka vijuar deri në mes të janarit 2017.
- Është realizuar mbështetja metodologjike ndaj Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Marrja e rezultateve nga këto dy vrojtime do të lejojnë përpunimin dhe publikimin e informacionit lidhur me përdorimin dhe mbulimin e tokës.

**Aktivitete në proces**

- Po vijohet puna për pastrimin dhe përpunimin e treguesve kalibrues për censusin e bujqesisë.
- Po vijohet mbështetja metodologjike si dhe takimet e vazhdueshme lidhur me vrojtimin vjetor në bujqësi.

**FUSHA PRIORITARE 11 STATISTIKAT SHUMËQËLLIMORE DHE EFIÇENCA E FITUAR NË PRODHIM**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**Moduli 11.01.52 Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave**

**Aktivitete të realizuara**

- Hartimi i kalendarit të dokumentimit të produkteve statistikore
- Menaxhimi i Metadatave Referenciale
    - Prezantimi i situatës së metadatave (referenciale + strukturore) stafit të INSTAT;
    - Vënia në dispozicion e udhërrëfyesve në shqip për mënyrën e plotësimit të formatit ESMS;
    - Finalizimi i katër raporteve të metadata-ve sipas formatit ESMS për produktet: ASN 2015, Popullsia 1 janar 2017, Energjia Elektrike 2016, IÇP/HICP 2016;
    - Përputhja e produkteve statistikore të INSTAT me produktet që kërkohen metadata nga EUROSTAT (PP18).
- Menaxhimi i Metadatave Strukturore
    - Misioni në lidhje me Metaplus me ekspertet suedez (kontrolli i dokumentimit të burimeve administrative në sistem);
    - Workshop me sektorët prodhues për dokumentimin e produkteve në sistem dhe mënyrën e përdorimit të sistemit;
    - Finalizuar dokumentimi në shqip dhe anglisht i Tregtisë së jashtme, Anketa e Qumështit, Cmimet e input/output në bujqësi, ASN, ATN.

**Aktivitete në proces**

- Menaxhimi i Metadatave Referenciale
    - Ngritja e sistemit të metadata-ve referenciale në kuadër të PP18 (“Developing a metadata system”);
    - Raportimi me anë të pyetsorëve (kërkuar nga eksperti i PP18) në lidhje me plotshmërinë dhe cilësinë e raporteve të metadata-ve;
    - Raporti metadatave (shqip dhe anglisht) sipas formatit ESMS për produktet: Lejet e Ndërtimit, Tregtia e Jashtme, ATN;
    - Raporti metadatave (shqip dhe anglisht sipas formatit ESQRS për produktet: Anketa e Forcave të Punës, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve.
- Menaxhimi i Metadatave Strukturore
    - Vazhdimi i dokumentimit të produkteve statistikore/administrative në Metaplus;
    - Parashikimi i një workshop të dytë (Metaplus) me stafin e statistikave prodhuese.

**Problematika**

Procesi i dokumentimit të produkteve statistikore është një proces impenjativ, sidomos për dokumentimin e metadatave strukturore të skedarëve administrativë(të pa shoqëruar me dokumentim të përshtatshëm), si edhe në rastin e vrojtimeve voluminoze(me një numër shumë të madh variablash). Në këto raste u ofrohet ndihmë dokumentuesve gjatë procesit të dokumentimit, nga stafi i sektorit të Bazave të të Dhënave dhe Metadatave.

**Nënmoduli 11.01.52.02 Aplikimi i Generic Statistical Business Process Model (GSBPM)**

**Aktivitete të realizuara**

- Përgatitja e udhërrëfyesit draft të standardit Generic Statistical Business Process Model(GSBPM).
- Përgatitja e një databaze për integrimin e GSBPM të plotësuara nga drejtoritë e prodhimit të statistikave dhe ndjekja javore e procesit të plotësimit/përditësimit të aktiviteteve statistikore.
- Gjenerimi i raporteve të ndryshme nga databaza e GSBPM për monitorimin e punës.

**Aktivitete në proces**

- Përmirësimi i vazhdueshëm i databazës së GSBPM të plotësuara nga drejtoritë e prodhimit të statistikave dhe ndjekja javore e procesit të plotësimit/përditësimit të aktiviteteve statistikore.
- Gjenerimi i raporteve të ndryshme nga databaza e GSBPM për monitorimin e punës.

**Problematika**

Ndjekja e aktiviteteve statistikore sipas modelit GSBPM është një proces i ri për INSTAT, në pëmirësim të vazhdueshëm. Vështirësia kryesore qëndron në uniformizimin e fazave dhe nënfazave të procesit të prodhimit statistikor. Për këtë është përgatitur udhërrëfyesi i standardit

Generic Statistical Business Process Model(GSBPM) si edhe u është ofruar ndihmë përdoruesve për planifikimin e proceseve.

**Nënmoduli 11.01.52.03 Cilësia Statistikore**

**Aktivitete të realizuara**

**Menaxhimi i Cilësisë**

- Prezantimi i situatës së menaxhimit të Cilësisë stafit të INSTAT
- Anketa e Kënaqësisë së Stafit të INSTAT:
  - Ndërtimi i Pyetësorit;
  - Hedhja e të dhënave;
  - Përgatitja e raportit me gjetjet kryesore.
- Anketa e Kënaqësisë se Përdoruesve:
  - Ndërtimi i Pyetësorit.
- Finalizimi i punës për template-in e raportimit të cilësisë i cili përmban:
  - Instruksionet për plotësimin e raporteve të cilësisë nga specialistët e fushës;
  - Tekstet standarde për t'u ndjekur;
  - Shembuj ilustrues.
- Krijimi i dokumentit për Angazhimin e Cilësisë së INSTAT.
- Ndjekja e projekteve të ndryshme që sektori është pjesë në IPA MB 2014 dhe Sida.

**Përgatitja e Raporteve të Cilësisë**

- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve 2015 për publikim.
  - Raporti i Cilësisë;
  - Llogaritja e Indikatorëve të Cilësisë.
- Përgatitja e raportit Shqip për raportimin e cilësisë për Cilësie për Popullsinë 1 Janar 2017
  - Raporti i Cilësisë;
  - Llogaritja e Indikatorëve të Cilësisë.

- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Indeksi i Çmimeve të Konsumit dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit 2016
    - Raporti i Cilësisë;
    - Llogaritja e Indikatorëve të Cilësisë.
- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Bilancin e Energjisë Elektrike 2016
    - Raporti i Cilësisë;
    - Llogaritja e Indikatorëve të Cilësisë.
- Përllogaritja e Indikatorëve të cilësisë për Anketën e Forcave te Punës:
    - Tremujori i Tretë, 2016
    - Tremujori i Katërt, 2016.

**Aktivitete në proces**

- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Lejet e Ndërtimit;
- Përgatitja e raportit Anglisht për raportimin e cilësisë për Cilësie për Popullsinë 1 Janar 2017;
- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë Tregtia e Jashtme;
- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Anketën e Forcave të Punës;
- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Anketën e Tremujore të Ndërmarrjeve;
- Përgatitja e raportit Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për Regjistrin e Biznesit;
- Përgatitja e raportit të Kënaqësisë së Përdoruesve me gjetjet kryesore;
- Ndjekja e projekteve të ndryshme që sektori është pjesë në IPA MB 2014 dhe Sida.

**Problematika**

Hartimi i raporteve të cilësisë është një proces i ri për INSTAT, në pëmirësim të vazhdueshëm. Vështirësia kryesore qëndron në uniformizimin e plotësimit të koncepteve, për pordukte të ndryshme statistikore, sipas modeli të përzgjedhur (SIMS ver.2). Për këtë është përgatitur manuali i përdorimit të SIMS si edhe u është ofruar ndihmë përdoruesve për plotësimin e tij.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**MODULI 16.03.54 MBROJTJA E TË DHËNAVE**

**Aktivitete të realizuara**

**Ambjent pune i sigurt, i mbrojtur nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme**

- Janë kryer të gjitha procedurat standarte për sigurinë e të dhënave, (backup servera, update antivirus, active Exchange Online Protection etj).
- Janë respektuar të gjitha politikat për një LAN të siguruar nga ndërhyrjet e jashtme apo të bredshme si dhe janë zbatuar të gjitha proçedurat përkatëse.
- Janë zbatuar të gjitha politikat për të mbrojtur rrjetin nga viruset.
- Është bërë e mundur mirëmbajtja e sistemit kompiuterik duke realizuar herë pas here update të të gjitha pajisjeve.

**Aktivitete në proces**

- Marrja e të gjitha masave të nevojshme për një ambient pune të sigurt, të mbrojtur nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme;
- Mbështetja e përdoruesve për zgjidhjen e problemeve apo vështirësive në përdorim të rrjetit, programeve kompjuterike ose defekteve hardware.

**Problematika**

Serverat dhe PC e INSTAT janë shumë të amortizuar dhe ka qenë e veshtirë mirëmbajtja e tyre. INSTAT është duke iplementuar projektin “Sida prokurim i drejtpërdrejtë për infrastrukturën e re IT si edhe për ngritjen e një qendre trajnimi”, i cili do të sigurojë pajisje të reja për dhomën e serverave si edhe stafin e INSTAT.